



URDHRI I INFERMIERIT TË SHQIPËRISË

STRATEGJI 2022-2025

Publikuar :
Janar 2022





Përmbajtja

Fjala e Blerina Duka, Presidente e Urdhrit të
Infermierit të Shqipërisë

Fjala e Gennari Rocco, Drejtor Shkencor i i Qendrës
së Ekselencës, Drejtor i Departamentit të Kërkimeve

01 Parathënie –një shikim mbi strategjinë

02 Kush jemi dhe çfarë bëjmë

03 Konteksti strategjik

04 Konsultimet strategjike –me kë folëm dhe çfarë dëgjuam nga publiku

Nga publiku

Nga infermierët, mamitë dhe profesionistë

të kujdesit shëndetësor

Nga partnerët tanë përfshirë edukatorët dhe
rregullatorët e tjerë profesionistë të kujdesit
shëndetësor

Nga kolegët e UISH-së

05 Temat tona strategjike

Përmirësimi dhe inovacioni

Mbështetja proaktive

Një rregullator më i dukshëm dhe i informuar

Angazhues dhe fuqizues

Depërtimi dhe ndikimi

Përshtatu me të ardhmen

06 Si mund ta kuptojmë se po ja dalim mbanë?

Fjala e Blerina DUKA, Presidente e UISH

Ne jemi rregullatorë të disa prej profesionistëve më të besuar dhe më të vlerësuar në Shqipëri: infermierët, mamitë, fizioterapistët, teknikët e imazherisë, teknikët e laboratorit ,logopedistët dhe ndihmës-infermierët.

Janë të shumtë ata që janë duke u kujdesur për njerëzit në shumë aspekte të kujdesit shëndetësor dhe social, dhe mbështesin gratë dhe familjet e tyre gjatë shtatzënive dhe lindjeve. Të tjerët janë të përfshirë në mbështetjen shëndetësore, duke u kujdesur për të gjithë në mirëqenien tonë fizike dhe mendore. Disa të tjerë po mësojnë të sapoardhurit në profesionet e tyre, duke udhëhequr projektimin dhe ofrimin e shërbimeve, ose zhvillojnë njohuritë në fushat e tyre përmes kërkimit.

Ne po lançojmë strategjinë tonë të re në vitin 2022. Gjithashtu ky është një vit në të cilin bota po përballet me një nga emergjencat më të mëdha të shëndetit publik, pasi po lufton me ndikimin e koronavirusit (Covid-19). Kjo ka pasojë shumë të mëdha, jo vetëm për shëndetin dhe kujdesin, por edhe për shoqërinë më të gjerë dhe ekonominë globale.

Profesionistët e kujdesit shëndetësor janë konsideruar shtylla kurrizore dhe nuk kanë qenë kurrë më të rëndësishëm se ne këtë kohë pandemie në mbarë globin.

UISH ka një privilegj të jashtëzakonshëm dhe

përgjegjësinë e rregullatorit të profesionistëve të kujdesit shëndetësor në Shqipëri. Mënyra se si ne rregullojmë do të jetë kryesore për vizionin tonë për një "praktikë të sigurt, efektive dhe të kujdesshme të infermierisë , mamisë dhe profesionistë të kujdesit shëndetësor duke përmirësuar shëndetin dhe mirëqenien e të gjithëve".

Gjatë vitit të kaluar ne kemi bashkëpunuar me shumë kolegë për të krijuar këtë strategji. Unë jam shumë mirënjohëse për të gjithë ata që janë përfshirë, na kanë sfiduar dhe na kanë inkurajuar të jemi ambicioz. Së bashku, ne kemi zhvilluar një vizion për të ardhmen tonë që do të na ndihmojë në udhëheqjen përmes sfidave të papritura të koronavirusit (Covid-19) dhe çfarëdolloj sfide të re që mund të na presë gjatë pesë viteve të ardhshme. Por ajo që ka vërtet rëndësi është se si ne e përkthejmë atë vizion në punë. Siç tha Nelson Mandela: "Vizioni pa veprim është vetëm një ëndërr, veprimi pa vizion thjesht harxhon kohën dhe vizioni me veprim mund të ndryshojë botën".

Blerina Duka

Presidente UISH

Kolegët tanë të UISH-së dhe Keshillit Kombëtar kanë ngritur zërin e tyre, duke theksuar se si mund ta përmirësojmë këtë ent publik për të qenë më efektiv. Ne e kemi shndërruar gjithë këto opinione të pasura në një strategji për pesë vitet e ardhshme dhe pjesa tjetër e këtij dokumenti përmbledh pikat kryesore; shpjegon se si Dëgjojmë vazhdimisht që njerëzit duan që ne të bëjmë më shumë, të përdorin njohuritë dhe inteligjencën tonë për të ndikuar në mjedisin sfidues që ndryshon me shpejtësi, në të cilin punojnë infermierët, mamitë dhe profesionistët e tjerë të kujdesit, duke ndihmuar në zgjidhjen e sfidave të fuqisë punëtore, pabarazisë dhe rreziqeve e siguri

Fjala e Gennaro Rocco
Drejtor Shkencor i Qendrës së Ekselencës
Drejtor i Departamentit
të Kërkimeve

01

Parathënie një
shikim mbi
strategjinë



Qëllimi i UISH-së është:

“ Të promovojë dhe mbështesë standardet më të larta profesionale në infermieri, mami, fizioterapi, teknik imazherie, teknik laborator, logopedi dhe ndihmës-infermierët për të mbrojtur publikun dhe për të frymëzuar besimin tek profesionistët.”

Strategjia jonë 2022–2027 bazohet në thjeshtësinë dhe qartësinë e tre roleve kryesore që mbështesin qëllimin tonë: rregullimi, mbështetja dhe ndikimi.

Ne **rregullojmë** në interes të publikut, duke u dhënë njerëzve besim në profesionet tona. Ne besojmë se për ta bërë këtë mirë, kërkohet angazhim i qëndrueshëm dhe kuptimplotë publik.

Roli ynë rregullator rritet kur ne **mbështesim** publikun, profesionet tona dhe partnerët tanë. Ofrimi i mbështetjes emocionale/shpirtërore dhe praktike për të gjithë ata që janë të përfshirë në proceset tona, sjell rezultate më të mira për të gjithë. Sigurimi i udhëzimeve të dobishme, në bashkëpunim me punëdhënësit, i ndihmon profesionet tona të ruajnë standarde të larta profesionale në praktikë. Kjo **ndihmon në realizimin e fokusit** tonë drejt praktikës së mirë, dhe jo praktikave të dobëta, jo vetëm duke iu përgjigjur gabimeve, por duke i parandaluar ato.

Aktivitetet nga puna jonë dhe bashkëpunimi me partnerët për të adresuar shqetësimet reciproke, do të na mundësojë të **ndikojmë** pozitivisht në kontekstin e të mësuarit dhe të kujdesit. Deri në vitin 2027, partnerët tanë duhet të na shohin si një zë-eksperti të vlerësuar, duke përfituar nga njohuritë unike që ne jemi në gjendje të sjellim.

Së bashku, kjo do të na ndihmojë të realizojmë vizionin tonë për:

“Punë të sigurt, efektive dhe të sjellshme të infermierëve dhe punonjësve të kujdesit, duke përmirësuar shëndetin dhe mirëqenien e të gjithëve”.



STRATEGJIA UISH 2022–2027

Vlerat tona mbështesin gjithçka që bëjmë. Ato i japin formë mënyrës se si ne mendojmë dhe veprojmë.

Ne jemi të drejtë

Ne i trajtojmë të gjithë me drejtësi. Drejtësia është në qendër të rolit tonë si një rregullator i profesionit, i besuar dhe transparent.

Ne jemi të sjellshëm

Ne punojmë me dashamirësi dhe në një mënyrë që e vlerësojmë njeriun, njohuritë, situatat dhe përvojat që ka.

Ne jemi bashkëpunues

Ne i vlerësojmë marrëdhëniet që kemi (si brenda ashtu edhe jashtë UISH-së) dhe e kuptojmë se po bëjmë më të mirën kur punojmë mirë me të tjerët.

Ne jemi ambiciozë

Ne jemi krenarë me punën tonë. Ne jemi të hapur ndaj mënyrave të reja të punës dhe gjithmonë synojmë të bëjmë më të mirën për profesionistët në regjistrin tonë, për publikun të cilit i shërbejmë dhe për njëri-tjetrin.

Strategjia e UISH-së në një faqe

Qëllimi

Promovimi dhe mbështetja e standardeve të larta profesionale në infermieri dhe profesionistët e tjerë të kujdesit shëndetësor, duke mbrojtur publikun, e duke frymëzuar besimin e publikut.

Vizioni

Një profesionist i kujdesit shëndetësor i sigurt, efektiv dhe i kujdesshëm, duke përmirësuar shëndetin dhe mirëqenien e të gjithëve.

Rregullo

- Një **regjistër** i saktë dhe transparent
- **Standarde** të forta profesionale
- Hartimi i **programeve praktike sipas standarteve të OBSH**
- Edukimi në vazhdim për të ecur me kohën dhe shkencën
- Përgjegjigje me **përgjegjshmëri** ndaj ankesave **duke përmbushur standardet profesionale**.

Mbështet

- Te promovojmë **mirëkuptimin**
- Profionet tona dhe rolin .
- Të sigurojmë **mjete praktike**
- Të ndihmojmë në vendosjen e standardeve
- **Të japim mbështetje emocionale dhe praktike** për njerëzit e përfshirë në proceset tona.

Ndiko

- Të promovojmë **mjedise pune profesionale** pozitive dhe gjithëpërfshirëse
- Të ndajmë **të dhëna dhe njohuri** për të identifikuar rreziqet e dëmtimit dhe për të adresuar sfidat e sigurisë dhe shëndetit në punë
- Të inkurajojmë **inovacionin rregullator**

Temat

2022–2027

Përmirësimi dhe inovacioni | Mbështetja proaktive | E dukshme dhe më e informuar | Angazhimi dhe fuqizimi | Depërtimi dhe ndikimi


Vlerat

I drejtë

Dashamirës

Bashkëpunues

Ambicioz



02

Kush jemi dhe
çfarë bëjmë



Kush jemi dhe çfarë bëjmë

Ne jemi rregullatori profesional për infermierët, mamitë, fizioterapeftët, imazheristët, laborantët, logopedët dhe ndihmës-infermierët në Shqipëri. Misioni jonë është përcaktuar në ligjin nr. 9818 të Urdhrit të Infermierit të Shqipërisë 2007 (i ndryshuar):

Objektivi kryesor i UISH në ushtrimin e funksioneve të tij është mbrojtja e publikut.

Ndjekja nga UISH e objektivit të tij kryesor përfshin ndjekjen e objektivave të mëposhtëm:

- mbrojtja, promovimi dhe ruajtja e shëndetit, sigurisë dhe mirëqenies së publikut;
- nxitja dhe ruajtja e besimit të publikut në profesionet e rregulluara me këtë Urdhër;
- promovimi dhe ruajtja e standardeve dhe sjelljes së duhur profesionale për anëtarët e këtyre profesioneve.

Përgjegjësitë tona rregullatore përfshijnë:

- Ne kujdesemi për regjistrin e infermierëve, mamive, fizioterapeftëve, imazheristëve, laborantëve, logopedëve dhe ndihmës-infermierëve që plotësojnë kërkesat për regjistrim në Shqipëri.
- Ne vendosim kërkesat e arsimit profesional që i mbështet njerëzit të zhvillojnë njohuritë, aftësitë dhe sjelljet e nevojshme për futjen në regjistrin tonë.
- Ne i japim formë praktikës së profesionistëve në regjistrin tonë duke zhvilluar dhe promovuar standartet përfshirë edhe Kodin tonë Etik dhe Deontologjikë, dhe ne promovojmë të mësuarit gjatë gjithë jetës përmes rivlerësimit.
- Kur ngrihen shqetësime serioze në lidhje me përmbushjen e standardeve profesionale të një profesionisti, ne mund të hetojmë, dhe nëse është e nevojshme, të ndërmarrim masa. Organi ynë drejtues është Këshilli Komëtar i cili përbëhet nga 25 persona dhe punon në zbatim të Ligjit të UISH-së, Statutit dhe Kodit Etik Deontologjik. Ne bashkëpunojmë me MSHMS dhe me Fakultetet e Infermierisë, me Shoqatat e Pacientëve dhe me Sindikatat e punonjësve.

UISH në shifra

Mbi:

23.800
Infermier

3,500
Mami

1743

Fizioterapi

2,171
Teknik Laboratori

808

Teknik Imazherie

261

Logopedi

230
Ndihmës-Infermier

Në regjistrin tonë janë

Në total mbi
30.000



Profesionistë që i bashkohen regjistrin tonë çdo vit
2000

40

Profesionistë
Nga jashtë



32.500
profesionistë



Janë mbi 30 000 njerëz në regjistrin tonë

Më pak se 1% i referohen procesit tonë të ankesave për përmbushje të standardeve profesionale

03

Konteksti strategjik

Konteksti strategjik me të cilin përballemi është sfidues.

Ndryshimi i kontekstit të kujdesit

Nevojat në ndryshim të njerëzve që përdorin shërbimet e kujdesit shëndetësor, duke përfshirë plakjen dhe sëmundjet e shumëfishta, krahas përparimeve mjekësore dhe teknologjike, kërkojnë mënyra të reja për të punuar në mjedise të reja. Në të gjitha institucionet shëndetësore publike dhe private aktualisht po futen metodat e reja të kujdesit dhe teknologjitë digjitale po bëhen pjesë integrale e praktikës klinike. Ka më shumë punë multi-disiplinare në grup brenda kujdesit shëndetësor dhe në të gjithë sektorët e tjerë. Praktikuesit po punojnë gjithnjë e më shumë përtej kufijve tradicionalë të profesionit.

Pabarazitë shëndetësore

Këtu janë dallimet sistematike dhe të shmangshme në rezultatet shëndetësore midis grupeve të ndryshme të njerëzve. Personat me aftësi të kufizuara, ata që vijnë nga grupe me gjendje të vështirë socio-ekonomike, grupet etnike me ngjyrë dhe pakicat e margjinarizuara, dhe ata që jetojnë në zonat më të thella, që marrin shërbime shëndetësore jo cilësore por që ndikojnë në jetesën e tyre të shëndetshme. Disa grupe gjithashtu e kanë më të vështirë të aksesojnë kujdesin shëndetësor cilësor dhe të gjithanshëm. Profesionet tona duhet të ndihmojnë në zgjidhjen e këtyre pabarazive, dhe ne si rregullator i tyre të rrisim standardet profesionale dhe të mbështesim kujdes cilësor.

“Mbështetja e një profesioni nën presion dhe ofrimi i kujdesit të mirë dhe të sigurt për pacientin nuk mund të bëhet i izoluar. Ne do të ishim të nderuar të punonim me institucionet shëndetësore dhe vendore për këto çështje... Është një përpjekje veçanërisht e rëndësishme, ndërsa praktika lëviz drejt një modeli të kujdesit në ekip.”

Kultura e vendit të punës

Ne e vlerësojmë diversitetin e infermierëve, mamive dhe profesionistëve të tjerë në regjistrin tonë si një pasuri për sektorin e kujdesit shëndetësor. Ne kemi nevojë për me shumë profesionistë të kualifikuar. Ne kemi profesionistë me formime të ndryshme dhe aftësi të ndryshme, por ne do punojmë gjithnjë për rritjen e cilësisë tek profesionistët e kujdesit shëndetësor për dhënien e kujdesit në standartet e kërkuara.

Të mësosh nga gabimet në kujdesin shëndetësor

Është e domosdoshme që të nxjerrim mësim nga gabimet në kujdes, për të ndihmuar në uljen e rrezikut të gabimeve në të ardhmen. Kujdesjet cilësore nga ofruesit ndikojnë për rritjen e cilësisë së shërbimeve shëndetësore të cilat do të çojnë në uljen e gabimeve ose të dëmtimeve tek pacientët e rrisuar. Mekanizmat më të sofistikuar të mbledhjes dhe analizës së të dhënave ofrojnë mundësi për rregullatorët që punojnë në bashkëpunim, për të kaluar nga një qasje reaktive në një qasje më proaktive dhe parandaluese.

“Hulumtimet ... kanë treguar një dështim në dëgjimin e zërit të pacientit.... Pra, “përdorimi më i mirë i të dhënave” duhet të zbatohet për reagimet e pacientëve po aq sa për provat klinike”

Ngarkesa në punë dhe lëvizjet e fuqisë punëtore.

- Ngarkesat në punë të cilat pasohen me numër të lartë të pacientëve në ndjekje , shkak për stres dhe ulje të cilësisë.
- Vlersimi jo korrekt i meritave ose i performancës së tyre dhe hapsirat për karrierë.
- Vlersimi ekonomik , kushtet e punës,motivimi, siguria dhe shëndeti në punë .

Ne do të bashkëpunojmë me punëdhënësit për të vlerësuar ngarkesën në punë dhe për të ulur stresin duke nxitur cilësinë e kujdesit dhe duke rritur numrin e punonjësve.Lëvizjet e profesionistëve jashtë vendit kanë ndikimin e tyre ,por ne do punojmë për një motivim më të mirë të profesionistëve tanë.

Emergjencia dhe qëndrueshmëria klimatike

Ndryshimet klimatike kanë një ndikim në shëndetin e njeriut që nga fëmijëria deri në pleqëri, me efekte që përfshijnë kequshqyerjen, sëmundjet kardiovaskulare, ato pulmonare, onkologjike dhe vdekjet nga kushtet atmosferike dhe ndotja e ambientit. Shërbimet shëndetësore dhe të kujdesit kanë gjithashtu një ndikim të rëndësishëm mjedisor duke i dhënë përparësi çështjeve të mjedisit, krahas atyre të shëndetit seksual dhe riprodhues, dobësive të lidhura me moshën, dhunën dhe veseve të dëmshme për shëndetin.

Reforma rregullatore

Ne jemi të përkushtuar të punojmë me qeverinë dhe palët e tjera të interesuara për të ndihmuar në modernizimin e kuadrit legjislativ për rregullimin profesional në kujdesin shëndetësor dhe social.

Kërcënimet e reja të sëmundjeve


Koronavirusi i ri (COVID-19) demonstroi dobësinë e sistemeve shëndetësore kur përballen me një sëmundje për të cilën nuk ka trajtim të menjëhershëm të disponueshëm. Rritja e mikroorganizmave rezistente ndaj antibiotikëve është gjithashtu një shqetësim në rritje. Rregullatorët kanë një përgjegjësi të veçantë në kontekstin e emergjencave shëndetësore. Ne duhet të punojmë me partnerët tanë në të gjithë vendin për shëndetin dhe kujdesin për të mbrojtur sigurinë publike, të udhëhequr nga këshillat e ekspertëve për shëndetin publik, duke pasur parasysh shëndetin dhe mirëqenien e profesionistëve tanë.

“Ndhmoni në adresimin e ngarkesës aktuale të fuqisë punëtore. Kjo ka ndikim të drejtpërdrejtë në kujdesin e ofruar dhe në gabimet e bëra”



04

Konsultimet për strategjinë - me kë folëm dhe çfarë dëgjuam



Në fillim të vitit 2021 ne filluam një program ambicioz angazhimi dhe konsultimi

Ne dëgjuam mbi 5,000 njerëz në shumë forume të ndryshme: **Ne do vazhdojmë të bëjmë:**

- Hulumtim të pavarur që përfshin anketa në internet dhe fokus grupe me publikun, të regjistruarit, kolegët e UISH-së dhe grupet që dëgohen rrallë.
- Një auditim i perceptimeve me palët kryesore të interesuara në vend.
- Dy sondazhe online ku pyetëm se ku duhet të fokusohemi në strategjinë tonë. Më shumë informacion rreth asaj që kemi dëgjuar është në faqen tonë të internetit.
- Një seri eventesh për takime angazhime rajonale me vendimmarrës dhe politikëbërës në vend.

T'i japësh formë të ardhmes

Me kë folëm dhe çfarë dëgjuam

Nga publiku

- Do përdorim ndikimin tonë për të theksuar se ku faktorët e vendit të punës lejojnë kujdesin e mirë dhe do ndërmarrim veprime aty ku ka pasur dështime.
- Do të rrisim profilin tonë për të rritur besimin në infermierinë dhe profesionistët e tjerë dhe të sigurohemi që e dimë se çfarë mund të bëjmë nëse përjetojmë kujdes të dobët.
- Do të bëjmë punën tonë kryesore rregullatore në mënyrë që të mbështesim profesionet tona për t'u angazhuar pozitivisht në mësim, përmirësim dhe siguri.
- Do të bëhemi më gjithëpërfshirës dhe më të arritshëm me ata që dëgjojmë dhe me ata të cilët angazhohemi dhe përtej atyre .

Për infermierët, mamitë , fizioterapeftët, imazheristët, laborantët, logopedët dhe ndihmës-infermierët.

- Na ndihmoni të ofrojmë kujdesin që të gjithë duam duke rritur ndërgjegjësimin për faktorët që vënë në rrezik kujdesin e mirë.
- Ndërtoni mirëkuptimin dhe vlerësimin e publikut për punën tonë dhe atë të profesioneve tona.
- Vazhdoni të përmirësoni shërbimet tuaja për të zgjidhur shpejt shqetësimet dhe sigurohuni që të gjithë të përfshirët, profesionistët dhe publiku, të kenë akses në mbështetje efektive.
- Jini më të dukshëm dhe bëni më shumë për t'u lidhur me kolegë të tjerë dhe në një gamë më të gjerë të mjediseve në të cilat ne punojmë.

“Ndërtoni mirëkuptimin dhe vlerësimin e publikut për punën tonë dhe atë të profesioneve tona”



Nga partnerët tanë duke përfshirë edukatorët dhe rregullatorët e tjerë profesionistë

- Vazhdoni të forconi marrëdhëniet tuaja me ne, duke përdorur ekspertizën tonë përkatëse, në mënyrë që të arrijmë më mirë në qëllimet e përbashkëta.
- Maksimizoni cilësinë dhe vlerën e proceseve tuaja kryesore rregullatore, duke përfshirë rivlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së formimit profesional.
- Përmirësoni dhe shpërndani të dhënat tuaja dhe përdorni njohuritë tona për të plotësuar tuajat.

Nga kolegët e UISH-së

- Sigurohuni që të kemi aftësitë, strukturën organizative, burimet dhe proceset e duhura për të ofruar strategjinë tonë.
- Përdorni më mirë të dhënat dhe njohuritë që kemi ne, në mënyrë që të zhvillojmë një zë udhëheqës në sektor dhe të ndihmojmë në përmirësimin e praktikës së infermierisë dhe profesioneve të tjera.
- Sigurohuni që njerëzit e të gjitha prejardhjeve pa dallim feje, ngjyre dhe ideje të kenë mundësi të barabarta për t'u zhvilluar dhe përparuar brenda organizatës sonë.
- Promovoni një këndvështrim të gjerë të punës sonë, duke e zhvendosur fokusin përtej ankesave për përmbushjen e standardit.
- Jepini prioritet rigorozisht, duke u siguruar që të gjitha ndryshimet të menaxhohen dhe të përfshihen në mënyrë efektive.

Do vazhdojmë të përmirësojmë punën tonë kryesore rregullatore

Prioriteti ynë kryesor është të bëjmë mirë punën tonë thelbësore rregullatore. Drejtimin e fokusit tek individit me marrjen e ankesave për përmbushjen e standardeve profesionale.

Përgjigjet ndaj konsultimit tonë zbuluan shumë keqkuptime dhe konfuzion midis pjesëmarrësve nga publiku dhe disa prej njerëzve në regjistrin tonë, për atë që bëjmë. Është e rëndësishme që njerëzit të dinë se çfarë mund të presin nga kujdesi i tyre, çfarë mund të bëjë dhe çfarë nuk mund të bëjë UISH dhe si të ngrenë shqetësime nëse është nevoja. Nxisni më shumë mirëkuptim të infermierëve, mamive, fizioterapeftëve, imazheristëve, laborantëve, logopedëve dhe ndihmës-infermierëve.

“Të jemi transparent, të përgjegjshëm dhe të matur ndaj publikut, për të cilët UISH kërkon të sigurohet që të regjistruarit të jenë të aftë për tu përshtatur me praktikën”

Të promovojmë mirëkuptimin për punën që bëjnë infermieret, mamitë, fizioterapeftët, imazheristët, laborantët, logopedët dhe ndihmës-infermierët.

Nuk ekziston një figurë tipike të një infermiereje, mamie, fizioterapefte, imazheriste, laborante, logopede apo ndihmës-infermiereje. Të regjistruarit tanë janë të ndryshëm dhe ata marrin rrugë të ndryshme drejt specialiteteve tona. Ky diversitet duhet të reflektohet më shumë në mënyrat e punës sonë, komunikimit, imazheve, politikave dhe standardeve.

Në të njëjtën kohë, ne duhet të nxisim mirëkuptim të asaj që bëjnë personat që janë në regjistrin tonë. Kjo përfshin ndryshimet midis roleve, si dhe nivelin e profesionalizmit dhe trajnimit të specializuar që ata kanë bërë.

“Publiku duhet të jetë më i ndërgjegjshëm se të regjistruarit rregullohen nga një organ profesional. Shumë na perceptojnë “vetëm infermierë” dhe nuk kanë asnjë ide për kërkesat që kemi për trajnim dhe Edukimin e Vazhdueshëm profesional që nevojiten për të arritur të qëndrojmë si praktikues të sigurt”

Të mbështesim infermierët, mamitë, fizioterapeftët, imazheristët, laborantët, logopedët dhe ndihmës-infermierët për të ofruar kujdes të mirë

Infermierët, mamitë fizioterapeftët, imazheristët, laborantët, logopedët dhe ndihmës-infermierët duan që ne të bëjmë më shumë për t'i mbështetur që të punojnë mirë, veçanërisht kur ata ngrenë shqetësime për sigurinë dhe shëndetin në punë ose janë të përfshirë në pamundësi për të vënë në praktikë procedurat.

Publiku gjithashtu mendon se profesionistët tanë duhet të mbështeten mirë në punën e tyre kërkuese.

I bëjmë jehonë asaj që thotë publiku për të ndikuar te të gjithë : " Respektoni standardet dhe ndihmoni në përmirësimin e tyre”

Performancë më të dukshme duke përfshirë një gamë më të gjerë njerëzish në punën tonë

Shumë njerëz na perceptojnë si të përqëndruar vetëm në Tiranë dhe duan që ne të sigurojmë që individë dhe organizata nga i gjithë kujdesi shëndetësor dhe social të përfshihen në punën tonë. Kjo përfshin ata që punojnë në UISH dhe në sektorët e pavarur, si dhe vullnetarë.

Ne duhet të dëgjojmë grupe të ndryshme, njerëz që identifikohen me karakteristika të ndryshme të mbrojtura, si dhe organizata që i përfaqësojnë ato, dhe ata që tradicionalisht mund të mos jenë të përfshirë në punën tonë.

“Të sigurohemi që angazhimi të jetë gjithëpërfshirës dhe të përfshijë të gjithë shtresat e popullsisë që kanë nevojë për kujdes”.

Ekziston një dëshirë e gjerë që ne të krijojmë një marrëdhënie më të ngushtë me studentët që do të jenë të regjistruarit tanë të ardhshëm. Kjo do të na japë njohuri mbi përvojat e studentëve për arsimimin e tyre dhe nevojat e tyre të hershme të karrierës. Kjo pasqyrë mund të ndihmojë në mbrojtjen kundër atyre që largohen nga profesioni para kohe. Mund të ndihmojë gjithashtu për të ndërtuar një pikëpamje më pozitive për rregulloren dhe mbështetjen që mund t'u jepte atyre.

“Ndriçojmë dhe inkurajojmë stafin dhe studentët se e ardhmja është më e mirë!”

Si na kanë parë profesionet tona



Si duan të na shohin profesionet tona



“Ne kemi nevojë për një fokus më të fortë në një kulturë të të mësuarit. Me gjithë vullnetin më të mirë në botë, gabimi njerëzor do të ekzistojë gjithmonë. Ne duhet të fokusohemi në sistemet që do ta reduktojnë këtë rrezik”

“Do të kishte vlerë të madhe që t'i bënim të dhënat e regjistruarve më të disponueshme për të tjerët. Kjo do të ndihmojë në mbështetjen e ofruesve dhe institucioneve shëndetësore me planifikimin e fuqisë punëtore”

Nxirrni në pah faktorët e vendit të punës që mund të nxisin kujdesin e mirë

Njerëzit duan që ne të bëjmë më shumë për të rritur ndërgjegjësimin për çështjet që rrezikojnë kujdesin e mirë, si: mungesa e fuqisë punëtore, bullizmi dhe ngacmimi, si dhe aksesit i kufizuar në zhvillimin profesional. Njerëzit mendojnë se ne duhet të jemi më proaktivë, duke ofruar më shumë udhëzime dhe mbështetje për përvojën më të mirë, duke i parashikuar problemet dhe duke reaguar ndaj tyre. Ne edukojmë me shembullin pozitiv.

Përdorni të dhënat dhe njohuritë tuaja për të mbështetur planifikimin më të mirë të fuqisë punëtore dhe përmirësimin më të gjerë të sistemit

Një mesazh i qëndrueshëm ishte vlera që mund të nxirrej nga të dhënat që mbajmë në regjistrin tonë, rivlerësimi dhe përshtatshmëria për rastet e ankesave për përmbushjen e standardeve profesionale. Ne do të krijojmë Regjistrin Kombëtar të Ankesave dhe Regjistrat Rajonale për profesionistët tanë për trajtimin e të gjithave ankesave në kohë dhe me vlerësim të plotë ,për të ruajtur sigurinë e pacientit gjatë dhënies së shërbimit nga profesionistët duke mësuar nga gabimet e të tjerëve.

05

Temat Tona strategjike



Pesë temat tona strategjike do t'na drejtojnë se si t'i caktojmë prioritet dhe të ndajmë fazat e punës sonë, si dhe investimet e reja në njerëz dhe burime të tjera.

01 Përmirësimi dhe inovacioni

02 Mbështetje proaktive për profesionet tona

03 Më i dukshëm dhe i informuar

04 Angazhimi dhe fuqizimi i publikut, profesionistëve dhe partnerëve

05 Depërtim dhe ndikim

01 Përmirësimi dhe inovacioni

Për të përmirësuar dhe rinovuar të gjitha funksionet tona rregullatore, duke ofruar shërbim më të mire ndaj antarëve dhe duke maksimizuar përfitimin publik nga ajo që bëjmë.

Pse kjo është e rëndësishme

Përgjegjësitë tona rregullatore ligjore janë unike për ne dhe janë themeli i gjithçkaje që bëjmë. Bërja e tyre mirë është një prioritet kryesor për ata me të cilët angazhohemi.

Çfarë po ndërtojmë

- Ne kemi thjeshtuar dhe automatizuar shumë nga proceset tona të regjistrimit, duke e bërë shumë më të thjeshtë për ata që përmbushin standardet tona të bashkohen dhe t'i ribashkohen regjistrin tonë.
- Ne kemi përmirësuar kërkesat tona për aplikantët jashtë shtetit për t'u bashkuar me regjistrin tonë, kemi përmirësuar informacionin tonë mbështetës dhe e kemi bërë procesin tonë më të shpejtë dhe më efikas.
- Ne po udhëheqim inovacionin në menaxhimin e ankesave për përmbushjen e standardeve profesionale, duke nxitur zgjidhjen e hershme të rasteve të përshtatshme dhe duke ndjekur një qasje që nxit njohuri dhe korrigjim kudo që është e mundur.

Ku presim të jemi në vitin 2027

- Ne do të kemi procese lehtësisht të aksesueshme, mbështetje dhe këshilla për ata që ndërveprojnë me ne.
- Vlera e regjistrin tonë për publikun, të regjistruarit dhe punëdhënësit, do të rritet me informacion më të aksesueshëm, të saktë dhe të dobishëm.

Planet tona të reja

Ne do të:

- **Mbështesim** rrugë të reja me cilësi të lartë për regjistrimin e profesionistëve që përmbushin standardet tona për të lehtësuar aksesin në regjistrin.
- **Vazhdojmë të përmirësojmë mbështetjen** që u ofrojmë aplikantëve tanë jashtë shtetit dhe atyre që i mbështesin ata, duke zhvilluar modelin tonë të testit të kompetencës në përputhje me standardet tona të reja të aftësisë.
- **Hetojmë** sistematikisht ndikimin e faktorëve kontekstualë në përshtatshmëri me raste të ankesave, duke mbajtur një fokus në përgjegjshmërinë profesionale individuale. Kjo do të na ndihmojë të arrijmë rezultate më të drejta.
- **Përmirësojmë** qasjen tonë ndaj hetimeve të ankesave, për të përmirësuar përvojën dhe mbështetjen për ata që janë të përfshirë, qofshin profesionistë apo publik.



02 Mbështetje proaktive

Duke u mundësuar profesioneve tona të mbështesin standardet tona sot dhe nesër, duke parashikuar dhe formësuar praktikën e ardhshme të profesionistëve tanë.

Pse kjo është e rëndësishme

- Standardet tona duhet të reflektojnë dhe t'i përgjigjen ndryshimit të shpejtë dhe sfidues të mjedisit në të cilin po punojnë të regjistruarit tanë.
- Njerëzit kanë nevoja klinike më komplekse, të cilat gjithnjë e më shumë po frymezohen nga identiteti dhe vendi ku jetojnë. Regjistruarit tanë duhet të pajisen për të përmbushur më mirë këto nevoja.
- Rrugët komplekse të kujdesit dhe transferimet ndërmjet shërbimeve kërkojnë nivele më të larta të vendimmarrjes klinike nga ekipet e profesionistëve me një gamë aftësish.

Çfarë po ndërtojmë

- Një Kod i rifreskuar që përcakton standardet që njerëzit mund të presin nga profesionistët në regjistrin tonë.
- Standardet tona të reja të infermierisë, mamisë, fizioterapisë, imazherisë, laborantëve, logopedëve dhe ndihmës-infermierëve janë shumë më ambicioze dhe më të përqendruara tek e ardhmja se standardet e mëparshme, duke vendosur stekën më lart dhe duke zhvilluar profesionistë më fleksibël, të aftë për të punuar në një kontekst gjithnjë e më kompleks.
- 13 vjet rivlerësim të suksesshëm, proces që mbështet profesionistët të reflektojnë tek praktika e tyre dhe mënyrën se si kodi zbatohet në punën e tyre të përditshme.
- Duke mirëpritur bashkëpunëtorët tanë, ne kemi punuar ngushtë me punëdhënësit dhe edukatorët për të ofruar një mjedis mbështetës për profesionalizmin e tyre.

Ku presim të jemi në vitin 2027

- Standardet tona rregullatore, edukimi dhe procesi i rivlerësimit mbështet profesionistët tanë që të përmbushin dhe përshtaten më mirë me nevojat në ndryshim të njerëzve që përdorin shërbimet e kujdesit shëndetësor dhe social.
- Profesionistët tanë mund të aksesojnë burime dhe udhëzime që janë të dobishme gjatë gjithë karrierës së tyre, duke i ndihmuar ata të zbatojnë standardet tona në praktikë dhe të adresojnë sfida të reja, për shembull nga teknologjitë e reja dhe ato në zhvillim.

Planet tona të reja

- Një qasje të re dhe më dinamike për zhvillimin e standardeve profesionale, për t'iu përgjigjur me shpejtësi sfidave të reja profesionale, duke përfshirë rishikimin e Kodit Etik Deontologjik.
- Një grup të ri standartesh ambicioze të aftësisë pas regjistrimit të profesionistëve shëndetësor nëpërmjet Edukimit në Vazhdim, dhe një rishikim gjithpërfshirës i praktikës së avancuar të profesionistëve duke përfshirë shqyrtimin nëse nevojitet rregullimi.
- Publikimi i një sërë parimesh të përbashkëta për të mbështetur kujdesin më të mirë për infermierët, mamitë, fizioterapeftët, imazheristët, laborantët, logopedët dhe ndihmës-infermierët e sapo diplomuar dhe liçensuar.
- Forcimin e qasjes sonë ndaj rivlerësimit, duke u mbështetur në provat nga vlerësimi ynë.



03

Një rregullator më i dukshëm dhe i informuar

Të jemi në kontakt më të ngushtë me profesionistët tanë, punëdhënësit dhe edukatorët e tyre, në mënyrë që të mund të rregullojmë më mire mjedisin e të mësuarit dhe të kujdesit shëndetësor në vendin tonë.

Pse kjo është e rëndësishme

Ne e dimë se për të marrë vendime të mira dhe të informuara, duhet të kuptojmë më mirë gjerësinë dhe diversitetin e praktikës, profesionistëve dhe roleve të shumta. Disa nga të regjistruarit na shohin si 'të largët' dhe 'të paarrtshëm'. Ata mendojnë se ne flasim në një nivel shumë të lartë për profesionet tona dhe jo gjithmonë pasqyrojmë përvojat e tyre të praktikës.

Çfarë po ndërtojmë

- Ne do krijojmë shërbimin tonë të lidhjes me punëdhënësit, i cili siguron kontakt të rregullt midis ofruesve të shëndetit, kujdesit dhe UISH, veçanërisht , por jo vetëm për hetimin dhe zgjidhjen e shqetësimeve.

Ku presim të jemi në vitin 2027

- Një kontribues me vlerë dhe konstruktiv në zhvillimin e politikave dhe praktikave të shëndetit dhe kujdesit lokal/rajonar/kombëtar.
- Ne do të mund të vlerësojmë ndikimin e punës sonë rregullatore në grupe të ndryshme të regjistruarish, të mbështetur në një perceptim më të thellë të gamës së mjediseve në të cilat ata punojnë.
- Antarësia jonë do të marrë përgjigje në kohë ndaj nevojave të tyre individuale.

Planet tona të reja

- Ne do të shqyrtojmë dhe zhvillojmë praninë tonë në zonat lokale në të gjitha rajonet e vendit duke mbajtur në fokus ofruesit dhe duke zgjeruar më tej rrjetet tona të bazuara në rajone.
- Ne do të zhvillojmë marrëdhënie më të ngushta me të regjistruarit tanë të ardhshëm - studentët dhe aplikantët e ardhshëm jashtë shtetit.
- Ne do të forcojmë fokusin tonë në shërbimin ndaj klientit, do të përdorim më mirë automatizimin dhe do të përdorim matje gjithëpërfshirëse të kënaqësisë së klientit për të nxitur përmirësimin.



04 Angazhues dhe fuqizues

Të jemi angazhues, aktiv dhe fuqizues të publikut, të profesionistëve dhe partnerëve tanë. Një UISH e besuar dhe e përgjegjshme, duke ndërtuar në mënyrë aktive një kuptim të asaj që ne dhe profesionistët tanë bëjmë për njerëzit.

Pse kjo është e rëndësishme

- Njerëzit duan të përfshihen në punën tonë më rregullisht. Ata duan bashkëpunimin dhe angazhimin për hir të tyre. Ne duhet t'i fuqizojmë njerëzit që të marrin pjesë në mënyrë kuptimplotë duke u siguruar që ata të kuptojnë se çfarë bëjmë ne dhe se si mund të ndihmojnë dhe ndikojnë në përmirësimin e rezultateve.
- Ne duhet të dëgjojmë nga grupe të ndryshme, njerëz dhe organizata që punojnë në një sërë rolesh dhe mjedisesh të ndryshme, si dhe nga ata që identifikohen me karakteristika të ndryshme të mbrojtura. Ne duhet të përpiqemi të dëgjojmë nga ata që tradicionalisht mund të mos kenë qenë të angazhuar në punën tonë dhe të bashkëpunojmë me organizatat e tyre përfaqësuese.

Çfarë po ndërtojmë

- Të mësuarit nga përvojat e suksesshme të angazhimit të qëndrueshëm dhe bashkëprodhimit, për shembull, në zhvillimin e standarteve të reja të aftësisë.
- Takime të rregullta të një sërë grupesh këshillimore të përhershme për të formësuar punën tonë.
- Lidershipi me përvojë në organizatën tonë me përgjegjësi specifike për mbështetjen dhe angazhimin publik.

Ku presim të jemi në vitin 2027

- Marrëdhënie më të forta dhe më kuptimplotë me partnerët tanë në të gjithë vendin.
- Ne kemi artikulluar qartë se çfarë do të thotë një qasje e përqëndruar tek personi, në mënyrë që publiku, profesionet tona, kolegët tanë dhe të tjerët të mund ta përdorin për të na kërkuar llogari.
- Publiku, profesionet tona dhe partnerët tanë e vlerësojnë bashkëpunimin si qasjen tonë të zakonshme ndaj zhvillimit të standarteve dhe politikave.
- Perceptim më i mirë publik për profesionet dhe rolin tonë.

Planet tona të reja

- Një qasje më sistematike dhe të targetuar për angazhimin e palëve të interesuara në të gjithë vendin.
- Të biem dakord dhe të vendosim një qasje të përqëndruar tek personi në të gjithë aktivitetin tonë rregullator, duke testuar progresin tonë nëpërmjet një programi angazhimi publik.
- Të bëjmë një fushatë informimi publik për t'i ndihmuar njerëzit të kuptojnë se çfarë bëjmë ne dhe profesionistët tanë.



05 Depërtimi dhe ndikimi

Të mësojmë nga të dhënat dhe kërkimet për të përmirësuar atë që bëjmë dhe të punojmë në bashkëpunim për të ndarë njohuritë me përgjegjësi për të ndihmuar në përmirësimin e një sistemi më të gjerë të shëndetit dhe kujdesit.

Pse kjo është e rëndësishme

- Vështrimet nga puna jonë, së bashku me kërkimet dhe provat nga burime të tjera, do të na ndihmojnë të përmirësojmë mënyrën se si rregullojmë dhe të nxjerrim në pah çështjet që po ndikojnë në aftësinë e profesionistëve për të praktikuar në mënyrë të sigurt dhe efektive.
- Është e rëndësishme për partnerët tanë që jo vetëm të jemi të përkushtuar për të punuar së bashku, por edhe të jemi të aftë dhe të pajisur mirë për të luajtur një rol pozitiv dhe për të shtuar vlerën në aktivitetin bashkëpunues.

Çfarë po ndërtojmë

- UISH po vlerëson dhe analizon të dhënat nga burime të brendshme dhe të jashtme, për të përmirësuar njohuritë nga rastet e ankesave dhe për të vënë në dukje rreziqet që mund të kërkojnë veprime rregullatore.
- Bashkëpunim më i ngushtë me rregullatorët dhe palët e tjera të interesuara për të identifikuar situatat që mund të përbëjnë një rrezik të vazhdueshëm për publikun ose profesionistët, psh nëpërmjet krijimit të regjistrit të ankesave.
- Punën tonë me rregullatorët e tjerë për të zhvilluar mënyra të përbashkëta për mbledhjen dhe analizimin e të dhënave, për shembull, marrjen e njohurive mbi çështjet rreth diversitetit dhe përfshirjes së barazisë.
- Përpjekja intensive e bashkëpunimit për të krijuar me sukses dhe shpejt një regjistr të përkohshëm emergjence Covid-19 në bashkëpunim me institucionet shëndetësore.

Ku presim të jemi në vitin 2027

- Informacioni i aksesueshëm, i saktë, i dobishëm dhe më i përshtatshëm në regjistrin tonë.
- Partnerët tanë të na shohin si një zë udhëheqës dhe të përfitojnë nga njohuritë dhe idetë e dobishme që sjellim në tryezë për çështje si profilet e karrierës dhe faktorët kontekstualë të rrezikut.
- Ne do të kemi një historik të të folurit për një mjedis pune të shëndetshëm, gjithëpërfshirës dhe pozitiv për profesionet tona.

Planet tona të reja

- Publikimi i të dhënave dhe statistikave në mënyra inovative që i shtojnë vlerë sistemit më të gjerë të shëndetësisë dhe kujdesit.
- Publikimi i një raporti vjetor "Gjendja e Arsimit dhe Praktikave të Profesionistëve të kujdesit " për të ofruar një pasqyrë të kontekstit në të cilin punojnë dhe trajnohen profesionistët tanë.
- Puna e ngushtë me MSHMS dhe me të tjerë për të bërë përmirësime në kuadrin tonë legjislativ.
- Vlerësimi i ndikimit të punës sonë te njerëzit me karakteristika të ndryshme të mbrojtura dhe puna me të tjerët për të adresuar pabarazitë.



Përshtatu me të ardhmen

Qëllimet tona strategjike kanë implikime të rëndësishme për mënyrën se si ne veprojmë si organizatë. Ne do të përafrojmë kulturën, aftësitë dhe infrastrukturën tonë me synimet tona të reja strategjike.

Vlerat dhe sjelljet tona të reja

Vlerat dhe sjelljet tona do të ndikojnë në punën që bëjmë dhe mënyrën se si e bëjmë atë. Ato gjithashtu do të kenë një ndikim pozitiv në jetën e punës e kolegëve tanë. Ne do të përfshijmë vlerat dhe sjelljet tona të reja në proceset tona të rekrutimit dhe menaxhimit të njerëzve.



“Ne duam që kolegët tanë të jenë krenarë që punojnë për UISH-në. Ne do të sigurojmë që të gjithë kolegët të kenë mundësi të barabarta për të zhvilluar aftësitë dhe karrierën e tyre”

Aftësitë e përmirësuara

Strategjia dhe analiza

Aftësitë e përmirësuara analitike do të jenë kritike për zbatimin e suksesshëm të strategjisë sonë. Ne do të mbledhim dhe vlerësojmë në mënyrë të vazhdueshme materiale për të ardhmen e ofrimit të kujdesit shëndetësor, rregullimit dhe edukimit profesional, për të informuar vendimet e Këshillit Kombëtar të UISH-së.

Ne duhet të përmirësojmë cilësinë dhe përdorshmërinë e të dhënave tona, duke përfshirë kapacitetin që partnerët tanë të analizojnë vetë të dhënat tona.

Praktikë profesionale

Ne kemi të regjistruar në UISH si kolegë, si këshilltarë dhe që luajnë një rol kyç në punën tone rregulatore, si për shembull profesorë dhe vlerësues të arsimit. Duke parë se mbështetemi në ekspertizë të shëndoshë nga profesionet tona do të përmirësohet mënyra se si ne rregulojmë dhe rrisim besimin e profesioneve me punën tonë. Ne do të shikojmë përsëri mënyrën e aksesit dhe përdorimit të ekspertizës nga profesionet që rregulojmë në UISH.

Mbështetje për të mësuar dhe përmirësim të vazhdueshëm

Ne duhet të përmirësojmë përvojën e brendshme dhe të jashtme të kujdesit . Ne do të zhvillojmë aftësitë e të gjithë kolegëve tanë për të mësuar dhe përmirësuar vazhdimisht mënyrën se si punojnë.

Njeriu

Ne duam që kolegët tanë të jenë krenarë që punojnë për njerëzit. Ne do të sigurojmë që të gjithë kolegët të kenë mundësi të barabarta për të zhvilluar aftësitë dhe karrierën e tyre.

Infrastruktura jonë e re

Dizajni dhe administrimi i ri organizativ

Ne duhet të sigurohemi që të punojmë në mënyra që mbështesin ambiciet tona strategjike. Ne duhet të ndertojmë një strukturë të re që të ketë ndikim tek profesionistët e ardhshëm, studentë sot dhe profesionistë e drejtues të mirë nesër .

Teknologjia

Ne do të vazhdojmë të përmirësojmë teknologjinë tonë, në mënyrë që kolegët tanë të kenë mjetet e nevojshme për të punuar me efikasitet. Ne do të modernizojmë sistemet që mbështesin punën tonë rregullatore, për të na mundësuar që të ofrojmë shërbim të mirë ndaj antarëve të UISH-së dhe të na bëjë të ruajmë dhe përdorim të dhënat tona për të ofruar njohuri.

Përgjegjësia sociale e UISH-së

Ne jemi të vendosur të veprojmë me përgjegjësi dhe të operojmë në mënyrë të qëndrueshme në të gjitha aktivitetet tona:

- Ne veprojmë në mënyrë etike dhe në përputhje me vlerat tona. Politikat që kemi përshkruajnë angazhimin tonë ndaj praktikave etike të punës dhe të të drejtave të njeriut.
- Ne mbrojmë vlerat e barazisë, diversitetit dhe përfshirjes. Ne e vlerësojmë diversitetin e njerëzve,, vlerësojmë ata për të cilët kujdesemi dhe për të gjithë të antarsëuarit në regjistrin tonë.
- Ne do të llojmë më shumë për mirëqenien mendore dhe fizike të njerëzve që përdorin shërbimet tona.
- Ne kemi hartuar një plan qëndrueshmërie i cili përfshin mënyrën se si ne punojmë si ent rregullator. Ky plan përfshin aktivitete si Edukimin në Vazhdim , ngritja e Qendrës së Ekselencës , shkëmbimet dhe eksperiencat kombëtare dhe ndërkombëtare.

Ndërtimi i një plani pesëvjeçar

Ne jemi te qartë për shumë nga punët

e nevojshme ofrimin e strategjisë sonë,

por ka disa fusha që do të kërkojnë më

shumë kohë për t'u arritur plotësisht.

Ne jemi të vetëdijshëm se planet tona

duhet të jenë edhe fleksibël për të

marrë parasysh rrethanat gjatë

periudhës që mbulon strategjia. Për

shembull, pandemia e koronavirusit e

cila tashmë ka një ndikim të

rëndësishëm. Ne po krijojmë një panoramë

pesëvjeçare të punës që kemi

përpara.

06

Si mund ta kuptojmë se po ia dalim mbanë?

Njerëzit do ta kuptojnë që ne jemi:

- Të efektshëm dhe të drejtë në punën tonë thelbësore rregullatore, me vendime të shëndosha, proporcionale dhe në kohë që përforcojnë besimin në profesionet tona.
- Mbështetës të profesioneve tona për të mbajtur standardet e larta të praktikës dhe parashikimin e nevojave të tyre në të ardhmen.
- Të informuar nga provat, duke përdorur njohuritë tona dhe të tjerëve për të vlerësuar punën tonë dhe për të kontribuar në mënyrë efektive në punën bashkëpunuese drejt mësimi dhe përmirësimit më të gjerë.
- Të arritshëm, të dukshëm dhe të lidhur, me marrëdhënie të forta në nivel kombëtar dhe lokal me profesionistë që informojnë qasjen tonë rregullatore.
- Ofrues i mirë i shërbimit ndaj klientit, duke qenë të përgjegjshëm dhe të sjellshëm në ndërveprimet tona me njerëzit që janë të përfshirë në punën tonë.
- Një bashkëpunëtor i çmuar veçanërisht me partnerë si edukatorët dhe punëdhënësit tek të cilët ne mbështetemi për të na ndihmuar të mbajmë standarde të larta praktike.
- Mbështetës aktivë të publikut, profesioneve dhe partnerëve tanë për të kuptuar dhe formësuar atë që bëjmë.
- Një organizatë me kulturë, aftësi dhe burime që përmbushin qëllimet e saj strategjike.

Planet tona të UISH do të përcaktojnë detaje të mëtejshme mbi matjen e progresit tonë në zbatimin e strategjisë sonë. Ne do të ndjekim një kombinim të matjeve të performancës, perceptimeve, provave afatgjata dhe ofrimit të arritjeve të nivelit të programit, në mënyrë që të kemi një pamje sa më të gjerë të progresit tonë.

Disa nga masat që parashikojmë të përdorim përfshijnë:

- Treguesit e performancës që na ndihmojnë të monitorojmë cilësinë dhe afatin kohor të proceseve tona kryesore rregullatore.
- Raportim mbi ofrimin e përfitimeve në nivel programi.
- Hulumtime dhe vlerësime më të thella mbi ndikimin tonë.
- Auditim të matjeve dhe perceptimeve të përvojës së klientit.
- Evidencë mbi përfshirjen e palëve të interesuara, kush, ku, kur dhe si.
- Analiza e opinioneve mediatike.
- Angazhimi i punonjësve duke përfshirë sondazhin e stafit tonë.
- Performanca jonë kundrejt standardeve të njohura të barazisë dhe diversitetit.

Kjo strategji përcakton një program ambicioz pune që do të kërkojë që të gjithë ne në UISH të bëjmë ndryshime në mënyrën se si punojmë dhe sillemi.

Si organizatë ne do të punojmë shumë për të mbështetur këtë ndryshim në kulturë dhe do t'i ofrojmë të gjithëve mjetet dhe mbështetjen e nevojshme praktike. Procesi nuk do të jetë i menjëhershëm, por gjatë pesë viteve ne presim që të gjithë që punojnë në sistemin shëndetësor, të shohin dallime të dukshme.

Ne kemi besim se shumë njerëz që kanë dhënë kohën dhe ekspertizën e tyre me kaq bujari gjatë vitit të kaluar për të na ndihmuar të zhvillojmë këtë strategji, do të vazhdojnë të angazhohen me ne, të na stimulojnë të menduarit dhe punën tonë gjatë pesë viteve të ardhshme. Ne presim të punojmë së bashku për të siguruar dhe mbështetur standarde të larta praktike nga infermierët, mamitë dhe profesionistët e kujdesit – në të gjithë vendin tonë.



Adresa: Rruga Reshit Petrela, Te Dispanceria
Kati II, Tiranë www.urdhriinfirmierit.org /
uish_albania@yahoo.com